



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:046405

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05790822

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. N. nga Fushë Kosova dhe B.D. nga Gjakova, për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm në bashkëkryerje nga neni 294 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/IL.nr.351/22 të dt.28.02.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **03.06.2024**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra ,mbrojtësi të akuzuarit A.N.av. Mehdi Geci sipas autorizimit , mbrojtësit te akuzuarit B.D. av. Pek Kola sipas autorizimit si dhe të akuzuarve, me datën 04.06.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari A. N., nga fsh. . . . Komuna e Gjakovës, tani me banim ne Fushë Kosovë , blloku HHB ,Rr”. . . , data e lindjes . . . ,nga i ati A. dhe e ëma M. e vajzërisë B., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar , atë i dy fëmijëve , nr. ID . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. I akuzuari B.D., nga Gjakova ,Rr”. . . “ data e lindjes . . . , në Gjakovë, nga i ati I. dhe e ëma Z. e vajzërisë G.,ka të kryer fakultetin, i pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar , atë i dy fëmijëve ,nr. ID . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J a n ë f a j t o r

Sepse:

Nga data e pacaktuar gjerë me datën 12.10.2019, rreth orës 12:32 në Gjakovë në rr. “Dedë Gjon Luli”, saktësisht, në lokalit pa emër, pa mbishkrim, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, i pandehuri A.si pronar i lokalit ku kishte hapur biznes me aperata-lojra te fatit, ndërsa i pandehuri B. si menaxher, në bashkëkryerje, kanë organizuar dhe zhvilluar veprimtarinë e lojërave të fatit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një kontrole nga zyrtarët policor, të pandehurit janë zënë duke ushtruar veprimtarinë me lojëra të fatit në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (Ligji nr.06/L-155), ashtu që në lokalit e të pandehurit, natën kritike janë hasur tre (3) aparate të lojërave të fatit “Apex”, të ndezur dhe duke luajtur disa persona, të cilat aparate si dhe para kesh në vlerë prej 170 euro, të cilat sekuestrohen nga Dogana e Kosovës.

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, **Organizimi i Skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 parg.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,17,38,42,46,69, 70 ,71 par.1 nën. par.1.1 dhe 1.3 ,72 par.1 nën.par.1.6, neni 294 par.2 lidhur me nenin -31 të KPRK-së dhe neni 364 të KPP, të akuzuarit i

G J Y K O N

I. Të akuzuarin A. N.:

ME DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh,

Me kërkesën e mbrojtësit av.Mehdi Geci dhe pëlqimin e të akuzuarit A. N. , konform neni 44 të KPRK-së, Dënimi me burgim prej 150 (njëqind e pesëdhjet) ditësh,të akuzuarit A. N., **I ZËVËNDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1500(njëmijë e peseqind) Euro, e të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 90(nëntëdhjetë)ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

Nëse i akuzuari A. N. , nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në shumë prej **1500 (njëmijë e peseqind) Euro** , atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje **75 (shtatedhjet e pese)ditësh .**

II.Të akuzuarin B.D. :

ME DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh,

Me kërkesën e mbrojtësit av.Mehdi Geci dhe pëlqimin e të akuzuarit A. N. , konform neni 44 të KPRK-së, Dënimi me burgim prej 150 (njëqind e pesëdhjet) ditësh,të akuzuarit A. N., **I ZËVËNDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1500(njëmijë e peseqind) Euro, e të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 90(nëntëdhjetë)ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

Nëse i akuzuari A. N. , nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në shumë prej **1500 (njëmijë e peseqind) Euro** , atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje **75 (shtatedhjet e pese)ditësh .**

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej nga **20.00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **30.00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

Gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 269 të KPPK-së, të akuzuarve iu :

KONFISKOHEN: sendet e përdorura për kryerjen e veprës, si : 3 copa Aperata APEX 3 copa, monitor Aces, Monitor Hp, Roter Cisco, Dreambox, Serrer alhuma për kamerat e sigurisë, Tv monitor LG, si dhe të hollat në shumë prej 170 euro, të përshkruara si në vërtetimin mbi konfiskimin e përkohshme të sendeve të dt.12.10.2019, si dobi e përfituar me vepër penale, sendet dhe parat gjinden në Stacionin Policor në Gjakovë në dhomën e dëshmive.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.03.06.2024, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurori Qazim Xharra, lexoi aktakuzën , PP/II.nr.351/22 të dt.28.02.2023 , deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dukë i ditur pasojat dhe benefitet e pranimit të tillë , pranim është bërë pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre, po ashtu ky pranim i fajësisë gjene mbështetje të plote në shkresat e lendes që i janë bashkangjitur aktakuzës, në bazë të cilave vërtetohet gjendja faktike si ne dispozitiv të aktakuzës, njëherë edhe elementet qenësore të kësaj veprë penale. Lidhur me vendimin për dënim i propozon gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ,të këtë parasysh edhe shkallen e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërisë se veprës penale me të cilën ngarkohen, gjithashtu me rastin e caktimit ,vlerësimit dhe individualizimit të dënimit ,të këtë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar të gjitha rrethanat si ato lehtësuese si pranimit i fajësisë ,e si rrethanë renduese të këtë parasysh dashjen e lartë të kryerjes së veprës penale , e po ashtu faktin se nga vet deklarimi i të akuzuarve se të njëjtit janë përsëritës të veprës penale ,po ashtu gjykatës i propozoi që pajisjet e specifikuar si në dispozitiv të aktakuzës të konfiskohen si mjetet me të cilat është kryer vepra penale si dhe dobia pasurore .

I akuzuari **A. N.** ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Mehdi Geci deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën pandehet sipas akuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë ,shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, me që jam i pa punë ,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës të me shqiptojë një dënim me të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit **A. N.** ,av.Mehdi Geci deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im , ashtu që pas konsultimeve të mjaftueshme me mua i ka kuptuar të gjitha pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë ,dhe ashtu siç u deklarua edhe vetë është penduar për një veprim të tillë ,dhe për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, dhe që i premtojë gjykatës se nuk do të përsërisë veprimet e tilla, që të aprovohet pranimit i fajësisë nga gjykata . Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se i propozoi gjykatës që të merr si rrethanë lehtësuese pranimit të fajësisë dhe të shqiptojë një dënim me të butë të cilën dënim do të mund të shendohej në dënim me gjobë.

I pandehuri **B.D.** , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av/ Prek Kola , deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën pandehet sipas akuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë ,shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, me që jam i pa punë ,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës të me shqiptojë një dënim me të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit **B.D.** , av.Prek Kola deklaroi pajtohet me pranimin e fajësisë dhe i propozoi gjykatës që ky pranim i fajësisë të aprovohet .gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer , por të njëjtin e kam kryer për shkak të gjendjes ekonomike me që isha i pa punë dhe si familjar me është dashur të sigurojë të ardhura për familje ,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm,

andaj i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm , të me shqiptojë një dënim me të butë . Lidhur me vendimin për dënimin i propozoi gjykatës që të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë dhe të shqiptojë një dënim me të butë e po që se gjykata parasheh të i shqiptojë një dënim me burgim deri në 6 muaj , të njëjtin me pëlqimin e të akuzuarit të e shndërrojë në dënim me gjobë

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit A. N. dhe B.D. , ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit , pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit A. N. dhe B.D. : - **Nga data e pacaktuar gjerë** me datën 12.10.2019, rreth orës 12:32 në Gjakovë në rr. “. . .”, saktësisht, në lokalit pa emër, pa mbishkrim, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, i pandehuri A.si pronar i lokalit ku kishte hapur biznes me aparata-lojra të fatit, ndërsa i pandehuri B.si menaxher, në bashkëkryerje, kanë organizuar dhe zhvilluar veprimtarinë e lojërave të fatit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një kontrole nga zyrtarët policor, të pandehurit janë zënë duke ushtruar veprimtarinë me lojra të fatit në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (Ligji nr.06/L-155), ashtu që në lokalit e të pandehurit, natën kritike janë hasur tre (3) aparate të lojërave të fatit “Apex”, të ndezur dhe duke luajtur disa persona, të cilat aparate si dhe para kesh në vlerë prej 170 euro, të cilat sekuestrohen nga Dogana e Kosovës.-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Organizimi i Skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

4.Elementet e veprës penale

Në nenin 294 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale, Organizimi i Skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm e kryen: “1. *Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e veprimtarive të skemave piramidale, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Ndërsa paragrafi 2 parashihet se : *Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

5.Vendimet e gjyqtares së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarit A. N. dhe B.D. , i ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Organizimi i Skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm në bashkëkryerje nga neni 294 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.1 dhe 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin konstaton faktin se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, peshën e veprës penale, dashjen e kryerjes së veprës penale si dhe fakti se nga se Evidenca penale PDP për të akuzuarit rezulton se i akuzuari A. N. ka qenë i dënuar me aktgjykimin PKRnr.1178/20 neni 366 i Gjykatës Themelore në Prishtinë dënim me gjobë#00 eurio i PF.13.01.2022 ndërsa i akuzuari B.D. ka qenë i dënuar me aktgjykimin P.nr.494/20 – neni 294 i, dënim me gjobë 1200 euro, i PF 23.02.2021 ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se të njëjtit janë prindër me nga 2 fëmijë, të pa punë me gjendje të dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, sjelljen tejet korrekte në gjykatë , kërkim falja publike, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet të cilat rrethana ndikuan që gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 72 të KPRK-së, gjykata të akuzuarve iu shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , me bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarve it nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin sendeve të përdorura për kryerjen e veprës, si : 3 copa Aparata APEX 3 copa, monitor Aces, Monitor Hp, Roter Cisco, Dreambox, Serrer alhuma për kamerat e sigurisë, Tv monitor LG, si dhe të hollat në shumë prej 170 euro, të përshkruara si në vërtetimin mbi konfiskimin e përkohshme të sendeve të dt.12.10.2019, si dobi e përfituar me vepër penale, është marr konform nenit 269 të KPPRK-ës.

7.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushalli gjyqësor në shumë prej nga 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 449 të KPPK-së., ndërsa vendimi mbi pagimin

e shumës prej nga 20.00 euro, u murr konform nenit 39 paragraf 3 nën paragraf 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushalli gjyqësor në shumë prej nga 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 449 të KPPK-së., ndërsa vendimi mbi pagimin e shumës prej nga 20.00 euro, u murr konform nenit 39 paragraf 3 nën paragraf 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.2022:046405 më datë 04.06.2024

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.